



BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO
AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE I KOSOVËS
BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA

33 Garibaldi Street Prishtina Kosovo UNMIK
Phone: +381 38 222 055 Fax: +381 38 243 763 Web: www.bpk-kos.org

Në përputhje me pushtetin dhe autoritetin akorduar nga Neni 5, 6 dhe 51 i **Rregullores së UNMIK Nr. 2001/24** Mbi Ndryshimin e **Rregullores së UNMIK Nr. 1999/20** mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, **Rregullores së UNMIK Nr. 1999/4** Mbi Valutën e Lejuar për përdorim në Kosovë, **Direktivës Administrative së UNMIK Nr. 2001/24** mbi Ndryshimin e **Direktivës Administrative së UNMIK Nr. 1999/2**, Zbatimin e **Rregullores së UNMIK Nr. 1999/4** mbi Valutën e Lejuar për përdorim në Kosovë, dhe në përputhje me Rregullin e Këshillit të BE-s Nr. 1338/2001 të datës 28 qershor 2001 mbi vendosjen e masave për mbrojtjen e euros kundër falsifikimit, si edhe në përputhje me orientimet e Bordit Drejtues të BPK-s miratuar në takimin e tij të datës 20 maj 2004 dhe rikonfirmuar në takimin e tij të datës 26 janar 2005.

Nëpërmjet kësaj BPK lëshon si vijon:

Rekomandim Nr. 1

Mbi Kontrollin e Standarteve për Riciklimin e Kartmonedhave nga Bankat Komerciale

Neni 1

Synimi

Ky Udhëzim u adresohet të gjitha institucioneve financiare që veprojnë në Kosovë, dhe që janë të licensuara nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (BPK).

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij Rekomandimi është vendosja e standarteve të kontrollit për riciklimin e kartmonedhave nga të gjitha institucionet financiare që operojnë në Kosovë, dhe që janë të licensuara nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (BPK). Në mënyrë të veçantë, qëllimi i këtij Rekomandimi është vendosja e standarteve të nevojshme me synimin për të garantuar integritetin dhe funksionimin e rregullt të ciklit të parave të gatshme.

Neni 3

Kërkesa të Përgjithshme

Bankat komerciale dhe mbajtësit e tjerë profesionistë të parave të gatshme mund t'i riciklojnë kartmonedhat euro me kusht që kartmonedhat e kthyera në qarkullim të jenë të kontrolluara në mënyrë të duhur për vërtetësinë dhe gjendjen e tyre në përputhje me kriteret e vendosura nga ky Rekomandim i BPK-s. Këto kontrolle duhet të kryhen nga makineritë ose nga anëtarët e trajnuar të stafit. Kartmonedhat të cilat nuk janë të kontrolluara për vërtetësinë dhe gjendjen e tyre nuk do të ri-nxirren në qarkullim dhe do t'i kthehen Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës.

3.1. Zbulimi i kartmonedhave të falsifikuara

Garantimi i një zbulimi me nivel të lartë të kartmonedhave të falsifikuara dhe parandalimi i rinxjerrjes së tyre në qarkullim është i një rëndësie të madhe. Prandaj, makineritë e prekjes së kartmonedhave të përdorura për vërtetimin e kartmonedhave euro duhet të jenë në gjendje të identifikojnë në mënyrë të sigurt dhe të klasifikojnë kartmonedhat euro të falsifikuara nga ato të vërteta. Kartmonedhat e falsifikuara dhe kartmonedhat e dyshuara si të falsifikuara do të dorëzohen menjëherë në Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, në përputhje me Udhëzimin Nr.2, lëshuar nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës. Stafi i cili kontrollon kartmonedhat gjithashtu do të veprojnë në përputhje me kushtet e vendosura në Udhëzimin Nr.2 të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, dhe **Rregullores së UNMIK-ut Nr.2004 / 2** Mbi Frenimin e Pastrimit të Parave dhe Shkeljet Kriminale të lidhura me të.

3.2. Zbulimi i kartmonedhave në gjendje jo të mirë

Kontrollet e gjendjes së kartmonedhave do të ndërmerren në përputhje me standartet minimale të klasifikimit për klasifikimin e gjendjes së kartmonedhave euro nga palët tregtare, siç është lëshuar nga Rekomandimi i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës. Kartmonedhat në gjendje jo të mirë duhet të kthehen përmes Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës në Sistemin-Evropian të Bankave Qëndrore Kombëtare, përmes rrugëve ekzistuese.

Në mënyrë që të sigurohet një funksionim i rregullt i ciklit të parave të gatshme, Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës do të vëzhgojë zhvillimin e nivelit të cilësisë së kartmonedhave euro në qarkullim. Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës mund t'i rishikojë këto standarte duke përcaktuar kufij më të ashpër për kriteret e vetme të gjendjes me qëllim mirëmbajtjen e cilësisë së kartmonedhave euro në qarkullim në Kosovë.

Neni 4

Klasifikimi i Kartmonedhave Euro dhe Trajtimi

Kur bëhet kontrolli i kartmonedhave në mënyrë manuale ose me pajisje verifikuese dhe/ose makineri përpunimi të kartmonedhave, duhet të zbatohen rregullat e mëposhtme:

Kate-goria	Klasifikimi	Karakteristikat	Trajtimi
A	<p>A1. Objekte të cilat nuk njihen si kartmonedha euro;</p> <p>A2. Objekte të identifikuar si faksifikim; dhe</p> <p>A3. Kartmonedha euro të dyshuara për falsifikim.</p>	<p>Objekte jo të zbuluara si një kartmonedhë euro të vërtetë për shkak të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gabimit të transportit (p.sh. dyfishimi i materialit, etj.); - Imazhit dhe formatit të gabuar; - Palosjeve të mëdha ose pjesëve që mungojnë; - Shënimeve me dorë, letrat ndarëse, etj.; - Monedha jo-euro; - Imazhit dhe formatit që njihen, por mungojnë një ose më shumë tipare të vërtetësisë ose që nuk kanë rezistencë; ose - Imazhit dhe formatit që njihen, por nuk njihen të gjitha tiparet e vërtetësisë për shkak të cilësisë dhe/ose shmangies së rezistencës. Në pjesën më të madhe të rasteve kartmonedha të grisura ose të njollësura. 	<p>AT1. Objekte të cilat nuk njihen si kartmonedha euro: p.sh. fletë e zbrazët, valuta të tjera dhe çeqe. Pas vlerësimit vizual nga anëtari i stafit këto objekte duhet të ndahen veçmas.</p> <p>AT2. Objektet të klasifikuara si falsifikim, duhet të shqyrtohen veçmas dhe të transportohen në BPK për vërtetësinë ASAP, por në çdo rast brenda dy ditëve pune pas shqyrtimit të këtyre kartmonedhave. Nuk duhet të depozitohen tek llogarimbajtësi.</p> <p>AT3. Kartmonedhat e dyshuara euro duhet të shqyrtohen veçmas dhe të kthehen më vete në BPK për vërtetësinë ASAP, por në çdo rast brenda dhjetë ditëve pune pas shqyrtimit të këtyre kartmonedhave. Mund të depozitohen tek llogarimbajtësi.</p>
B1	B1.1. Kartmonedha të identifikuar si të vërteta dhe në gjendje të mirë.	Të gjitha kontrollet e vërtetësisë dhe të gjendjes të bëra nga makineria dhanë rezultate positive.	B1T. Mund të përdoren për riciklim. Të depozitohen tek llogarimbajtësi.
B2	B2.1. Kartmonedha të identifikuar si të vërteta dhe në gjendje jo të mirë.	Të gjitha kontrollet e vërtetësisë të bëra nga makineria dhanë rezultate positive. Kontrollet e gjendjes të bëra nga makineria dhanë rezultate negative.	B2T. Nuk do të përdoren për riciklim dhe do të kthehen në BPK. Të depozitohen tek llogarimbajtësi.

Neni 5

Informacione mbi Kartmonedhat Euro dhe Tiparet e Tyre të Sigurisë

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës do të vazhdojë t'u japë pjesëmarrësve përkatës të tregut informacione mbi kartmonedhat euro dhe tiparet e tyre të sigurisë, në të njëjtën mënyrë siç veproi me ndryshimin e euros në vitin 2002.

Sistemi-Euro është duke botuar informacione mbi tiparet e caktuara të sigurisë së kartmonedhave euro për të nxitur palët e treta që të kontrollojnë kartmonedhat euro për vërtetësi, dhe Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës do të vazhdojë t'u japë pjesëmarrësve të caktuar të tregut informacione të tilla.

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës i rekomandon të gjitha institucionet financiare që të përdorin pajisjet e kontrollit të kartmonedhave, të cilat janë të testuara në mënyrë të suksesshme nga Sistemi-Euro i Bankave Qëndrore Kombëtare.

Neni 6

Hyrja në Fuqi

Ky Rekomandim do të hyjë në fuqi më datën 14 mars 2005.